

VENDIM
Nr. 184, datë 19.4.1997

PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.159, DATË 6.4.1997 “PËR MIRATIMIN NË PARIM TË PROJEKTMARRËVESHJES PËR STATUSIN E FORCAVE SHUMËKOMBËSHE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE KOMBEVE TË BASHKUARA (VENDEVE DËRGUESE)”

Duke u bazuar në rezolutën 1101 (1997) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, mbështetur në nenin 3 të ligjit nr.8203, datë 30.3.1997 “Për pranimin në Shqipëri të një force ushtarake shumëkombëshe në mbështetje të operacioneve humanitare”, duke pasur parasysh qëndrimin e shteteve pjesëmarrëse në forcat shumëkombëshe në procesin e bisedimeve, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.159, datë 6.4.1997, pika 1 ndryshohet si vijon:
“Të miratojë në parim projekt marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe qeverive të shteteve kontribuese në forcën mbrojtëse shumëkombëshe, lidhur me statusin e këtyre forcave, me vërejtjen që për juridiksionin të jetë varianti B në tekstin e bashkëngjitur”.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme që, mbi bazën e kësaj projekt marrëveshjeje, të zhvillojë bisedime me shtetet pjesëmarrëse në këto forca shumëkombëshe.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Fino